

KONTRATE SHITJE KUOTASH

PALA SHITËSE: **Lulzim Sahitaj**, i datëlindjes 07.09.1989; madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **H40216072B**.

Në këtë akt do të quhen «Palë Shitëse».

PALA BLERËSE: **Leonard Basha**, i datëlindjes 04.07.2000; madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **K00704053S**.

Ne në këtë akt do të quhen «Pala Blerëse».

BAZA LIGJORE: 1- Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare"
2- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;

Personat si më sipër identifikuar, me vullnet të lirë dhe të plotë, me kërkesë të shprehur personalisht, të informuar e në dijeni të pasojave ligjore në rast deklarimi të pavërtetë hartojnë këtë akt.

Sot më **24/10/2022** u mbledhën palët për sa më poshtë vijon:

RRETHANA PARAPRAKE

1. Shoqëria "LAVIVA TECHNOLOGIES" shpk është regjistruar si person juridik shqiptar me përgjegjësi të kufizuar, e identifikuar me numër NUIS: M01323012A, me adresë të selisë në Rruga e Kavajes, Condor Center, Kulla D, Nr.4, Tiranë.
2. Shoqëria nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është nën sekuestro apo nën formë tjetër të kufizimit të zotësisë së saj juridike dhe është e lirë për qarkullim civil të pjesëve të kapitalit të saj.
3. Pala shitëse është ortak në Shoqërinë "LAVIVA TECHNOLOGIES" shpk, duke zotëruar:
 - Lulzim Sahitaj ortak i subjektit dhe zotëron 1 kuotë me pjesëmarrje në përqindje 100% të kuotave të kapitalit me vlerë në para për 600.000Lekë.

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është:

- Shitjes së 1 (një) kuote të ortakut z. Lulzim Sahitaj, me pjesëmarrje në përqindje 100%, me vlerë në para 600.000 lekë (gjashtëqind mijë) me përfitues z. Leonard Basha

ÇMIMI I KONTRATËS

Me marrëveshje të përbashkët të dy palët kanë përcaktuar se:

- Leonard Basha do paguajë Çmimin total për blerjen e 1 (një) kuote së kapitalit të zotëruar nga Lulzim Sahitaj prej 600.000 (gjashtëqind mijë) Lek, me pjesëmarrje në përqindje 100%;
- Palët deklarojnë se Çmimi total për shitblerjen është likujduar totalisht nga blerësi përpara nënshkrimit të aktit.
- Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Pala Shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi pjesët të kapitalit në shitje dhe Pala Blerëse bëhen pronare të 100% (Njëqind për qind) të kapitalit.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pronësia mbi kapitalin e shoqërisë do të bëhet si vijon:

z. Leonard Basha

1 (një) kuote

Pjesëmarrja në përqindje: 100%;

Me Vlerë në para 600.000 lekë

DEPOZITIME TË PALËVE

Ky akt përpilohet në dy kopje, kopje të aktit ruhen nga palët dhe regjistrohen ndryshimet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për tu pasqyruar ndryshimi i pronësisë së shoqërisë LAVIVA TECHNOLOGIES shpk sipas detyrimeve ligjore.

Pasi kontrata lexohet me zë, palët deklarojnë se e gjejnë tërësisht, e paragraf për paragraf në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, japin pëlqimin e tyre për gjithçka më sipër dhe e nënshkruan aktin rregullisht duke vendosur emër mbiemër dhe firmë.

PALA SHITESE

Lulzim Sahitaj



PALA BLERESE

Leonard Basha